



Jeffrey C. Riley
Komisioneri

Departamenti i Masaçusetsit për Arsimin Fillor dhe Dytësor

75 Pleasant Street, Malden, Massachusetts 02148-4906

Telefon: (781) 338-3000

TTY: N.E.T. Relay 1-800-439-2370

Shtator 2023

Të nderuar prindër dhe kujdestarë të nxënësve të klasës së vitit 2025 (të rinj të shkollave të mesme):

Bashkëngjitur janë rezultatet e fëmijës suaj nga provimet MCAS të klasës së 10^{te} të pranverës 2023. Faqja e parë e raportit përmban një grafik që tregon rezultatet e fëmijës suaj nga vlerësimet në artet e gjuhës angleze, në matematikë, në shkencë dhe në teknologji/inxhinieri. Rezultatet janë të rëndësishme, sepse fitimi i një Përcaktimi të Kompetencës (CD) është një kërkesë e diplomimit. Përveç CD-së, studentët duhet të plotësojnë të gjitha kërkesat vendëse të diplomimit për të fituar një diplomë të shkollës së mesme.

Në **artet e gjuhës angleze (ELA) dhe nëmatematikë**, ekzistojnë tri rezultate të mundshme për provimin e fëmijës suaj. Fëmija :

- mund të ketë plotësuar kërkesën e diplomimit në MCAS në një ose në të dyja lëndët duke fituar një rezultat prej 472 ose më të lartë në ELA dhe 486 ose më të lartë në matematikë.
- mund të ketë arritur një rezultat midis 455 dhe 471 në ELA ose midis 469 dhe 485 në matematikë, por duhet të plotësojë një Plan të Aftësisë Arsimore (www.doe.mass.edu/assessment/epp) në atë lëndë me qëllim që të diplomohet. Çdo EPP do të përfshijë një rishikim të pikave të forta dhe të dobëta të fëmijës suaj, të kurseve që duhet të ndjekë dhe të përfundojë në klasat 11 dhe 12, si dhe një përshkrim të vlerësimeve që shkolla do të kryejë për të përcaktuar nëse fëmija juaj po përparon.
- mund të mos ketë plotësuar kërkesën për diplomimin në MCAS, dhe në këtë rast fëmija mund ta përsëritë provimin (disa herë nëse është e nevojshme) për të plotësuar kërkesën. Mundësitë e para të përsëritjes së provimit për ELA dhe matematikë janë planifikuar përkatësisht për datat 8-9 nëntor dhe 14-15 nëntor 2023.

Në **shkencë dhe teknologji/inxhinieri (STE)**, studentët në klasën e vitit 2025 do të përmbushin kërkesën e diplomimit në MCAS ose duke bërë provimin në biologji ose të hyrjes në fizikë, ose duke e pasur tashmë të kryerversionin e trashëguar të kimisë ose teknologjisë/inxhinierisë. Ju lutem vini re se provimet e qershorit 2023 në kimi dhe teknologji/inxhinieri ishin mundësitë e fundit për kryerjen e këtyre dy provimeve.

Në raportin e bashkëngjitur janë dy rezultatet e mundshme për provimin STE të fëmijës suaj. Fëmija juaj:

- Mund të ketë plotësuar kërkesën për diplomimin në STE, si më poshtë:
 - ka fituar një rezultat të shkallëzuar prej 220 (*Ka nevojë për përmirësim*) ose më të lartë në kimi ose teknologji/inxhinieri; ose
 - ka fituar një rezultat prej 467 ose më lartë në biologji, ose një rezultat prej 470 ose më të lartë në hyrje në fizikë.
- Nuk i ka plotësuar këto kërkesa, dhe në këtë rast fëmija juaj mund ta përsëritë provimin (disa herë nëse është e nevojshme) për të plotësuar kërkesën për diplomimin në MCAS. Mundësia e parë e përsëritjes së provimit në biologji dhe në hyrje në fizikë është planifikuar për datat 6–7 shkurt 2024.

Për studentët që nuk e kanë përbushur kërkesën as në artet e gjuhës angleze, as në matematikë, as një STE, procesi i apelimeve për performancën në MCAS ofron një mënyrë tjetër që studentët të tregojnë se kanë njohuritë dhe aftësitë që duhen për të përbushur ose tejkaluar standardin CD të shtetit.

Informacione shtesë, duke përfshirë kërkesat për pranimin, gjenden në

www.doe.mass.edu/mcasappeals, ose mund të kontaktoni drejtorin e shkollës së mesme ose zyrën e informacionit.

Rezultatet MCAS të fëmijës suaj mund t'u japin gjithashtu atyre kredit shkollimi në një kolegji ose universitet publik të Masaçusetsit. Studentët që kualifikohen për Bursën në John and Abigail Adams (www.doe.mass.edu/scholarships/adams) do të njoftohen automatikisht gjatë vitit të maturës. Studentët që pranohen për Certifikatën e Mjeshtërisë në Stanley C. Koplik (www.doe.mass.edu/scholarships/mastery) duhet të aplikojnë gjatë vitit të maturës.

Për studentët që nuk kanë plotësuar kërkesat e MCAS për diplomimin, ekzistojnë mundësi të tjera falas për t'i ndihmuar që të përgatiten për të ardhmen, si programe të shkollës së mesme, programe komuniteti për kolegji dhe programe pune dhe mësimore. Më shumë informacion rreth këtyre rrugëve të mundshme dhe rreth opsioneve të tjera mund të gjenden në www.doe.mass.edu/ccte/ccr/hqccp.

Nëse keni pyetje lidhur me rezultatet e fëmijës suaj, ju lutemi të flisni me konsulentin e orientimit të fëmijës suaj. Nëse ai/ajo nuk mund t'i përgjigjet pyetjes suaj, ju lutemi të na kontaktoni në mcas@doe.mass.edu ose 781-338-3625.

Me respekt,

Jeffrey C. Riley
Komisioner i Arsimit Fillor dhe Dytësor